


5.3 STUKO PËR PATINIME

SPATORELLA



Njësia matëse	Copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
15 kg/thes	80 cp/paletë	1kg/m ²	E Bardhë
5 kg/qese	4 cp/kuti	1kg/m ²	--



SPATORELLA

Stuko Patinimi për realizimin e rifiniturave të lëmuara.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Stuko patinimi e përbërë nga çimento e bardhë, pluhur mermeri i bardhë, rezina dhe aditivë special.

- Karakterizohet nga një punueshmëri dhe hapje e lehtë dhe pa rrëshkishmëri vertikale gjë që lehtëson aplikimin nëpër sipërfaqe vertikale.
- Përdoret për ambiente të brendshme dhe të jashtme.
- Lejon një trashësi nga 1 deri 3 mm për çdo dorë.
- Fërkohet lehtësisht me letër zmerile dhe jep një rifiniturë të lëmuar.
- Është konform normës EN 998 - 1

FUSHA E PËRDORIMIT

Për stukimin e mureve dhe tavaneve të mbushura me llaç tradicional ose me llaç të parapërgatitur me bazë gëlqere - çimento.

Stukimin e sipërfaqeve prej betoni.

Stukimin e mureve dhe tavaneve prej kartongipsi.

SHËNIME TË RËNDËSISHME

Mos shtoni përbërje të tjera si çimento apo gëlqere në produktin e dhënë.

Mos e aplikoni produktin mbi sipërfaqe të lyera.

Mos e aplikoni produktin mbi suportet të veshura me veshje plastike.

Nuk duhet të aplikohet në një trashësi më të madhe se 5 mm.

Mos shtoni ujë në përbërje mbasi ajo të jetë përgatitur.

Duhet të aplikohet në temperatura nga +5°C deri +35°C

PERFORCIMI ME LATEX

Për t'i përmirësuar ngjithshmërinë, papërshkueshmërinë nga uji, plasticitetin, elasticitetin, forcën mekanike etj, SPATORELLA mund të përforcohet me aditivin LATEX. Raporti i përzierjes është 1:5 me ujë.

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përzieni 15 Kg stuko patinimi me 4.5 - 5 litra ujë me përzierës elektrik me një numër të vogël rrotullimesh derisa të fitohet një masë homogjene. Rekomandohet që masa e fituar të lihet në qetësi për afro 5 minuta dhe të përzihet përsëri përpara përdorimit.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet që karakterizohen nga një disnivel më i madh se 3 mm, duhet të nivelohen paraprakisht përpara aplikimit të stukos. Suporti ku do të aplikohet produkti duhet të jetë pa lëndë të huaja të tilla si, yndyrna, verniqe, bojra, etj. Suporti duhet të laget me ujë përpara aplikimit të produktit.

MËNYRA E APLIKIMIT TË PRODUKTIT

Produkti përhapet në sipërfaqe nëpërmjet një spatule të lëmuar për të siguruar një përhapje dhe mbulim të plotë të sipërfaqes. Produkti aplikohet deri në një trashësi 3 mm nga një deri në dy duar.

PASTRIMI

Pastrimi i veglave të punës dhe i duarve duhet bërë gjatë kohës që produkti është tharë plotësisht.



TË DHËNA TEKNIKE (NË 23°C DHE 50% U.R)

Forma	Pluhur
Ngjyra	I bardhë
Ruajtja	12 muaj në paketim origjinal në vend të thatë
Djegshmëria	I padjegshëm
Raporti i përzierjes	4.5 - 5 litra ujë për 15 Kg SPATURELA
Dendësia e pluhurit	1.6 gr/cm ³
pH i përzierjes	12
Kohë zgjatja përzierjes	3 - 4 orë
Temperatura e aplikimit	+5°C deri ne +35°C
Trashësia maksimale në një dorë	1mm
Koha e pritjes për aplikimin e dorës së dytë	Pas 60 - 90 min
Koha e pritjes për fërkim	24 orë
Koha e pritjes për lyerje	3 - 4 javë

TË DHËNA PËRFUNDIMTARE

Rezistenza në shtypje mbas 28 ditëve	≥ 4,5 N/mm ²
Rezistenza në përkulje mbas 28 ditëve	≥ 1,7 N/mm ²
Forca ngjitëse në beton	≥ 0,5 N/mm ²